Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0985
Data e Vendimit: 15.12.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik ALTINN SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)" me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 15/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet e palejuar –si e parakohshme,ankesa e OE ALTINN SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0985, e datës 06/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga "KOMUNA E PODUJEVËS" nga cilësia e sas si autoriteti kontraktues (AK).

2. I lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.985/23 nga ALTINN SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Komuna e Podujevës lidhur me aktivitetin e lartcekur me datë 10.07.2023 ka publikuar B05 - Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 01.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Arsimi sh.p.k.

OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK me datën 05.12.2023 ora 09:28. Ndërsa Autoriteti Kontraktues me datën 08.12.2023 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, Komuna e Podujevës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 10.07.2023 ka publikuar B05 - Njoftimi për kontratë, me datën 01.12.2023 AK ka publikuar B58. OE ankues ALTINN SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK me datën 05.12.2023 ora 09:28. Me datën 06.12.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP ndërsa me datën 08.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ALTINN SH.P.K.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, ende pa pritur vendimin e AK rreth kërkesës për rishqyrtim i është drejtuar OSHP. Me datën 06.12.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP ndërsa datën 08.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ALTINN SH.P.K.

OSHP sqaron se OE ankues ka qenë i obliguar fillimisht të paraqes kërkesën për rishqyrtim brenda konform dispozitave ligjore dhe të pres vendimin e AK, me tutje pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes tek AK, ankesa duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, në OSHP.

Neni 109 i Ligjit për Prokurim Publik përcakton se "*Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji."* Po ashtu edhe neni 64.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik përcakton "*Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se."*

Sipas zyres ligjore konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 06.12.2023 nga OE ALTINN SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës, hedhet si e pa lejua/parakohshme sepse ankuesi nuk ka paraqitur ankesën në OSHP sipas dispozitave lartcekura. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

I lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Megjithatë,OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues **nuk duhet** që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj konfom dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

OSHP sqaron se i njëjti ankues pra OE ALTINN SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 05.12.2023 me numër protokolli Nr.981/23, e cila është cilësuar si ankesë e pa lejuar dhe të njëjtit i janë kthyer mjetet të cilat i ka deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP. Por ankuesi ALTINN SH.P.K serish ka parashtruar ankesë me numër protokolli Nr.985/23 duke e paraqitur dëshminë e pagesës se njëjtë, pra dëshmi e njëjtë e pagesës për të dy ankesat me numër protokolli 981/23 dhe 985/23. Dhe kjo tarifë e pagesës i është kthyer përmes vendimit me Nr.981/23 të datës 12.12.2023.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PODUJEVËS**
- OE - **ALTINN SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: